



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:262052

Datë: 13.11.2020

Numri i dokumentit: 01271763

A.nr.512/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike N. Sh., në konfliktin administrativ, të paditësit A.B. nga Prishtina kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, në seancën publike të mbajtur me datë 12.11.2020, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET Kërkesëpadia e paditësit A. B. nga P., si e pa bazuar

Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.01.3.2.2/25 datës 27.02.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e aktvendimit nr.03.1.1-2017 datë 13.12.2017 i lëshuar nga Sektori për kontroll Pas-Importuese, si të pabazuar.

Paditësi A.B. nga P. me padinë e datës 22.03.2018 të ushtruar në gjykat ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditures Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia, të anulohen vendimet e të paditurës.

Në padin e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësi deklaron: e kundërshtojmë në tërësi aktvendimin e palës së paditur, në këtë çështje të konfliktit administrativ, me pretendimet si vijon: në procedurë të zhdoganimit të pajisjeve për ruajtjen e qumështit të freskët (M.) në mënyrë të kundërligjshme janë shkelur dispozitat të Ligjit nr.04/L-163, që konsiston në lehtësirat doganore të parapara me instrumentet tregtare të Qeverisë, e që konsistojnë në shqyrtimin e gabuar të gjendjes faktike. Pajisjet si më lartë janë klasifikuar gabimisht sipas tarifës në pozicionin tarifor 8418690090, në vend të pozicionit tarifor 84349000000, siç qëndron në dokumentacionin autentik të liruesit të mallit, provë: shiko shkresat e lëndës, faturat dhe deklaratat eksportuese. Këto pajisje janë specifike për shkak të destinacionit të posaçëm që e kanë si pajisje të blegtorisë, e që në mënyrë funksionale janë të ndërlidhura me pajisjet tjera direkt për mjeljen e qumështit që përçohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezervar të qumështit, e kurrsesi si frigorifer të zakonshëm siç kanë konstatuar zyrtarët doganor të Tarifës, duke qenë se sipas Kodit Doganor dhe të Akcizave, mendimet e sektorit në fjalë nuk konsiderohen imperative, po sikur fakultative, Sektori i rishqyrtimeve këto konstatime i ka marrë si të

mirëqena, duke i mos përfillur faktet e pa kontestuara të mbështetura në prova materiale. provë: shiko shkresën e prodhuesit të Greqisë “M.”.

Shkelje tjetër procedurale është edhe mos ftesa e paditësit në procedurë të vendosjes për çështje me qëllim të ofrimit të informatave plotësuese dhe relevante si më lartë. Andaj konsiderojmë meqë barra e të provuarit mbi konstatimin e fundit të fakteve sipas dispozitave të LPA-së, bie te organi që e udhëheqë procedurën, ky obligim i paraparë nuk është përmbushur. Provat e prezantuara nga paditësi në këtë çështje kërkojnë me përvoja të avancuara të klasifikimit të mallrave sipas Nomenklaturës të tarifës doganore evropiane, të cilat e paditura i ka anashkaluar. Në këtë rast konsiderojmë që e paditura ka mundur ta shfrytëzoi edhe Institutin e të Drejtës për bashkëpunim të ndërsjellë juridik, ti drejtohet vendit eksportues me akt-lutje për konfirmimin e klasifikimeve tarifore siç janë prezantuar në procedurë. Propozoj që gjykata të merr aktgjykim, me të cilin aprovohet në tërësi Kërkesëpadia e paditësit, si e bazuar, të anulohet vendimi i të paditurës dhe të kthehen mjetet e paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit në shumën prej 12,567.40 Euro.

E paditura në përgjigje në padi datës 01.10.2019 deklaroi: e kontestojmë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar për arsye se vendimin i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore, dhe ajo me të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare, sepse pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Dogana e Kosovës, konstaton se ka vepruar drejtë me aktvendimin nr.03.1.1/2017-158 dt.13.12.2017, me q,rast ka eliminuar të metat e sjella në këtë aktvendim, dhe ka ngarkuar subjektin me taksat prej 12,567.40Euro, dhe jo siç ka qenë më herët 37,396.95 Euro, këtë vendim e bazon nga Mendimi tarifor i cili sektor ka shqyrtuar si sektor profesional i Doganës, dokumentacionin përcjellës të lëndës, faturave, importeve, fotove dhe shënimeve sqaruese të kapitullit 84, të dhënat nga web faqet zyrtare të prodhuesve dhe konstaton se mallrat janë deklaruar jo saktë duke u bazuar në rregulla gjenerale 1 dhe 6. Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, e paditura i propozon gjykatës që të merr Aktgjykim me të cilin ta refuzoi në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës; 12.11.2020, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e datës 01.10.2019 nga Dogana e Kosovës, aktvendimi 01.3.2.2/25 i dt.27.02.2018 i Doganës së Kosovës, aktvendimi nr.01.3.2.2/740 i dt.07.11.2017 i Doganës së Kosovës, aktvendimi 01.1.1/2017, i dt.04.10.2017 i Doganës së Kosovës, aktvendimi nr.03.1.1-2017-158, i dt.13.12.2017 i Doganës së Kosovës, fatura e dt.12.09.2017, Deklaratat Doganore, fatura e dt.11.08.2017, fatura e shitjes nr.692 e dt.05.12.2016, fatura e dt.28.11.2016, Iniciativa për zhvillimin e bujqësisë dt.16.11.2017, certifikata nr.501948-CE-ES e dt.31.05.2002, Konfirmimi i dt.16.10.2017, Mendim për Klasifikim Tarifor 04.1.2 Nr.86/28.09.2017 i Doganës së Kosovës, Kërkesa për Kontroll të Operatorëve Ekonomike e dt.14.06.2017 e Doganës së Kosovës, Raporti Informativ i dt.15.09.2017 i Doganës së Kosovës, ankesa e paditësit me nr.prot.25/12.01.2018, deklaratat eksportuese.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata nxjerr konstatimin se e paditura Dogana e Kosovës në procedurën administrative të ankesave ka konfirmuar aktvendimin nr.03.1.1-2017 dt.13.12.2017 të lëshuar nga Sektori për Kontroll Pas-Importues, me të cilat paditësi është obliguar për pagesën e taksave doganore dhe TVSH-së, në bazë të nenit 82 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, për shkak të

deklarimit jo të drejt të klasifikimit tarifor të mallit lëndor “kontejner (rezervuar) për ftohjen e qumështit-laktofriz”, të delaruar me kodin tarifor 8434900000, për të cilat pas verifikimit të kryer është konstatuar nga Sektori i Tarifës se kemi të bëjmë me kodin tjetër tarifor 8418690090, që sipas TARIK-ut i nënshtrohet pagesës së taksës doganore prej 10% dhe TVSH-së prej 18%, andaj paditësi është obliguar që ta paguaj taksën doganore dhe TVSH-në.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se në procedurën administrative gjendja faktike është vërtetuar drejt kur është nxjerr konkluzioni se paditësi ka bërë deklaram të pasaktë në kuptim të kodit tarifor të mallit lëndor “kontejner (rezervuar) për ftohjen e qumështit-laktofriz”, të deklaruar me DUD-at R14927/05.05.2015, R39728/26.09.2015, R46217/09.11.2015, R2828/15.02.2016, R14753/27.05.2016, pasi që nga dokumentacioni i siguruar gjatë vizitës tek paditësi, Sektori i Tarifës ka nxjerr Mendimin për klasifikim tarifor 04.1.2 nr.86/28.09.2017, me të cilin është bërë ndryshimi i kodit tarifor të mallit lëndor, e që sipas klasifikimit tarifor të ndryshuar malli duhet të paguaj taksë doganore prej 10% dhe TVSH-në prej 18%. Sektori i Tarifës mendimin e vet e ka bazuar në rregullat e përgjithshme 1-6 për interpretim e TARIK-2017, shënimeve shpjeguese të seksionit XVI, kapitullit 84, kreut 8418 dhe 8434, informatave të reja nga interneti të publikuara nga vet prodhuesit dhe deklaramet nga importues tjerë. Paditësi nuk ka provuar me asnjë dokument nga shteti eksportues apo prodhuesi i mallit lëndor, të ofroj informatat detyruese tarifore të mallit lëndor, që do të dëshmonin kodin tarifor të mallit.

Si rregull gjykata vendos konfliktin administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, dhe në bazë të nenit 81.F par.1 të Ligjit 04/L-102, në këtë rast paditësi bart detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që e mbështesin kërkesën e tij. Gykata nuk mund të merr për bazë pretendimet e paditësit për ta ndryshuar një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar e paditura pas verifikimit të dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor dhe përshkrimit të saktë të mallit lëndor, sepse paditësi nuk ka paraqit prova të argumentuara që dëshmojnë të kundërtën e Mendimit tarifor për klasifikimin e mallit lëndor, prandaj gjykata konstaton se e paditura ka aplikuar drejt dispozitat ligjore të neni 82 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës ku ka rezultuar se malli në fjalë i importuar nuk lirohet prej taksës doganore dhe TVSH-së. Gjkata e konsideron si të drejt kalsifikimin tarifor të ndryshuar nga Sektori i Tarifës-Dogana e Kosovës, pasi që kemi të bëjmë me një mall doganor “rezervuar për ruajtjen e qumështit”, që ka të integruar sistemin ftohës si pjesë përbërëse të rezervuarit që kontrollohet edhe nga termostati elektronik për përcaktimin e temperaturës ftohëse, përshkrim ky faktik të cilin nuk e ka kontestuar paditësi se malli doganor posedon edhe paisjet për ftohje. Gjkata nga TARIK-u 2017, ka konstatuar se ky përshkrim i mallit doganor është i harmonizuar me përshkrimin e mallit në kodin tarifor 8418 të TARIK-ut 2017.

Gjkata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi nr.01.3.2.2/25 datës 27.02.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.512 datë 12.11.2020

Gjyqtari
Krenar Berisha

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.